



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**

---

**EKSTRAKT I PROCESVERBALIT**

**të mbledhjes së pestë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 05.06.2019, e cila  
filloi në orën 10:00.**

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, Shpend Ahmeti, kryetar i Komunës, Selim Pacolli, nënkyretar i Komunës, Muhedin Nushi, nënkyretar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Nol Nushi (PSD), Drilon Pireva (PSD), Bashkim Beha (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Visare Gashi (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Adrian Berisha (PSD), Leonora Shabani – Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Valbona Petrovci, e pavarur, Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Eman Rahmani (LVV), Egzon Azemi (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Arbër Vokrri (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Sami Salihu (LDK), Milazim Vitija (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Naime Osmani (LDK), Elmire Nikçi – Rexha (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Migjen Shala (PDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Florida Canolli (PDK), Uran Ismaili (PDK), Sokol Berisha (AAK), Yll Bogaj (AAK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Suzan Kika (AAK), Bukurie Canolli (AAK), Fikneta Bejta (AAK), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR-AA), Sami Boroci, (AKR-AA), Arbenita Murseli (AKR-AA), Adelina Fazliji (AKR-AA) dhe Rifat Deri (AKR-AA).

**Munguan:** Baton Dushi (Nisma) dhe Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK).

Të pranishëm ishin edhe drejtoret e drejtive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të medieve të shkruara dhe elektronike dhe përfaqësues të OSBE-së.

**Kryesuesi konstatoi se me 32 vota për, 1 kundër, u miratua ky**

## Rend i ditës

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
2. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Fehmi Avdiut, Ruzhdi Cakollit, Bedrije Munishi-Xhela, Halil Munishit, Fadil Cakollit, Rinor Sinanit, dhe Xhafer Sinanit;
3. Propozimvendimi për themelimin e ndërmarrjes publike lokale "Kuzhina Qendrore" SHA, në Prishtinë;
4. Propozimvendimi për lënie në shqyrtim publik të Projektrregullores për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të komunës së Prishtinës;
5. Propozimvendimi për emërtimin e rrugës me emrin "Bernard Kushner";
6. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e Monumentit të Lirisë;
7. Pyetje dhe përgjigje;
8. Të ndryshme.

### Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt të Kuvendit të Komunës së Prishtinës

**Agim Gashi** bëri vërejtje në ekstrakt i cili tha se ekstrakti duhet të formulohet më mirë dhe fjalitë të jenë me kuptim të plotë.

**Halim Halimi** tha se në bazë të përbajtjes së transkriptit, është mirë që hartuesi i procesverbalit me i riformular fjalitë ashtu si duhet.

**Kryesuesi konstatoi se me 35 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së katërt të Kuvendit të Komunës së Prishtinës**

### Pika e dytë

**Propozimvendimi** për këmbimin e pronës së paluajtshme Komuna me pronën e paluajtshme në pronësi të Fehmi Avdiut, Ruzhdi Cakollit, Bedrije Munishi-Xhela, Halil Munishit, Fadil Cakollit, Rinor Sinanit dhe Xhafer Sinanit

**Agim Gashi** bëri vërejtje në material i cili tha se si te propozimi, ashtu edhe te vendimi po dihet se Komuna i jep sipërfaqe 150m<sup>2</sup>, por nuk dihet sa merr nga pronarët, pra aty mungon sipërfaqja e pronësisë të cilën do ta marr Komuna prej këtyre pronarëve. Kërkoi që kjo të riformulohet sakt.

**Fatos Dibra**, tha se kjo sipërfaqe do të definohet pasi që të kthehet nga ministria vlerësimi i pronave

**Me propozimin e dhënë që teksti të riformulohet sakt, Kryesuesi konstatoi se me 33 vota për, u miratua vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme Komuna me pronën e paluajtshme në pronësi të Fehmi Avdiut, Ruzhdi Cakollit, Bedrije Munishi-Xhela, Halil Munishit, Fadil Cakollit, Rinor Sinanit dhe Xhafer Sinanit**

### **Pika e tretë**

**Propozimvendimi për themelimin e ndërmarrjes publike lokale "Kuzhina Qendrore" SHA, në Prishtinë**

**Mirsad Vitia** tha se edhe për kundër iniciativës qëllim mirë që Komuna e Prishtinës mund ta ketë për një propozim vendim të tillë siç është në këtë rast themelimi i ndërmarrjes publike "Kuzhina Qendrore" fatkeqësish mund të shihet që ky plan biznesi është absolutisht jo i mirëfilltë dhe i pa qëndrueshëm.

Ky dokument që është sjell nga ekzekutivi nuk është një biznes plan dhe analizë financiare me të cilin mund të menaxhohet një ndërmarrje stabile dhe e suksesshme në të ardhmen. Lidhur me këtë propozim paraqiti disa vërejtje si në vijim:

Këtij biznes plani i mungojnë të dhënrat e performancës së ndërmarrjes që nga fillimi në bazë të së cilave është dashur të bëhen parashikimet; Rritja e parashikimit të numrit të shërbimeve nuk përkon edhe me rritjen e numrit të punonjësve të kuzhinës; Nuk është planifikim i mirëfilltë; Një kosto shtesë çdo katër vite është planifikuar për ndërrimin e gardërobës së punëtorëve në kuzhinë dhe servirueseve, kjo është qesharake; Kosto e mallit të shitur nuk mund të supozohet të mbetet e njëjtë për 5 vitet e ardhshme, pasi që kostoja e shportës së konsumatorit rritet në bazë të normës së inflacionit; Kur jemi tek normat e zhvlerësimit nuk mund ta kuptoj se nga janë marr ato 2% për ndërtesa, 7% për renovimet dhe 7% për pajisjet. Me vjen keq por ato duhet të përkijnë me normat e parapara sipas ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës; Tek pasqyrat e te hyrave mungojnë të dhënrat e viteve 2016-2017-2018? Ne kemi nevojë që të shohim trendin e performancës së ndërmarrjes në mënyrë që planifikimet tonë të jenë sa ma reale. Duhet të dimë nëse ka humbur apo ka fituar kjo ndërmarrje; A ka pasur grup profesionistësh ose ekspertesh për këtë dokument, nëse po kish me qen me rendësi për këtë Asamble të dimë kush ka qenë në grup punues që e ka përpiluar një dokument të tillë.

**Suzan Kika** tha se ndërmarrjet publike në Kosovë janë barrë e madhe shoqërore, funksionimi i tyre rrallë herë është në harmoni me ligjshmëri dhe interesat ekonomike, ngase para interesave të afarizmit të ndërmarrjeve involvoohen interesat politik. Kështu çdo ndërmarrje bëhet çerdhe e nepotizmit, e korruptionit dhe në vend që të jetë vatër e prodhimeve dhe shërbimeve përfshirë afarizëm të suksesshëm ndërmarrjet publike janë dhe bëhen strehë e akomodimeve dhe me punësimë e funksione pa asnjë kriter përfshirë të afërmit e politikës. Prandaj unë sot personalisht nuk do ta votojë themelimin e kësaj ndërmarrje që të bëhet edhe një barrë përfshirë Prishtinën dhe rrjedhimisht e tak sapaguesve prishtinas.

**Shpend Ahmeti** kryetar tha se në fakt kemi të bëjmë me punëtorë të cilët kanë punuar që 30 vite në Komunën e Prishtinës kështu që nuk janë të asnjë subjekti politik por thjesht janë punëtor të Komunës të cilët e kanë përgatitur ushqimin përfshirë çerdhe. Natyrisht një prej arsyeve që është marr vendimi që këta punëtorë të privatizohen ka qenë edhe fakti që Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Kuvendin e Republikës së Kosovës kanë kaluar legjislacion me të cilin i pamundësohet që punëtorët e kuzhinës, pastrimit, sigurim nuk

Faqe 3 nga 13

mund të jenë shërbimes civil. Si të tillë këto shërbime duhet të blihen me para dhe prej kompanive private, pra e kemi pas këtë problem te cilin kemi dashtë me e zgjidh dhe ideja ka qenë që me së miri është përmes ndërmarrjes publike për shkak se edhe e zgjidhim statusin e punëtorëve të cilët me nuk kanë nevojë të punojnë me kontrata mbi vepër por të kenë kontratë në ndërmarrje publike.

Çmimi do të jetë po ashtu i kontrollueshëm dhe i menaxhueshëm prej komune dhe na e mundëson që kuzhina qendrore të shes produkte edhe për çerdhet private të cilët kanë kërkesa. Mendoj që është plani i biznesit ndër ma të mirët dhe është përgatitur prej eksperteve.

**Agim Gashi** tha se edhe në Komitet për Politikë dhe Financa kam kërkuar disa të dhëna shtesë lidhur me këtë propozim. Ajo që ka qenë përmbajtjesore në diskutimin tim ka qenë që kjo ndërmarrje të mos kufizohet në një ndërmarrje që u shërben vetëm institucioneve parashkollorë. Propozoi që në pikën e dytë të vendimit tekstit ti shtohet: Ndërmarrja publike lokale themelohet me qëllim të furnizimit të kopshteve dhe për nevoja të institucioneve arsimore dhe nevoja të tjera të Komunës së Prishtinës.

**Shefki Gashi** tha se e përkrahi vendimin e grupit tim por përvoja po me thotë se me krijimin e këtyre ndërmarrjeve ne vetëm po e ngarkojmë buxhetin, po e përkrahim një grup të vogël individësh dhe po i shkelim të tjerët.

**Eman Rahmani** tha se ne jemi për krijimin e kësaj ndërmarrje, por arsyaja pse i kemi vërejtjet tona është për shkak që kjo tash nuk po krijohet në bazë të planit të biznesit që e ka paraqit ekzekutivi vetëm për ti rehatuar 4 anëtarë të bordit dhe një shef ekzekutiv. Asnjë arsyje tjetër në bazë të planit të biznesit nuk ka për themelim të kësaj ndërmarrje. Asnjë ndryshim për shkak të veprimtarisë që e ka bërë deri tash nuk do të ketë kjo ndërmarrje. Ne jemi për themelin e kësaj ndërmarrje, mirëpo kjo ndërmarrje të jetë funksionale për shkak që ka shumë mundësi për me punuar dhe për me bërë ndryshime në Komunën e Prishtinës. Është shumë e rëndësishme që fëmijët tanë të ushqehen shëndetshëm dhe të ushqehen me ushqim të mirë e kjo ndërmarrje do të mund të ofronte një ushqim ku do ti kënaqte të gjithë fëmijët edhe prindërit edhe për sigurinë në ushqim.

**Egzon Azemi** tha se ne konsiderojmë që mund ta themelojmë një ndërmarrje që do të jetë më shumë në shërbim të qytetarëve dhe të atyre që kanë nevojë. Nëse i analizojmë shifrat dhe shpenzimet që bëhen nga kiflet dhe nga qumështi përafërsisht na del që kostoja përfurnizimin me qumësht për nxënësit nga klasa 1 deri në 5 është rreth diku 750.000 euro pothuaj se një shifër e ngjashme është edhe tek furnizimi me kifle. Kur e kemi parasysh se një numër i madh i këtyre kifleve mbresin në korridoret e shkollave dhe nuk përdoren nga fëmijët, atëherë na del se me shumë pak të holla shtesë do të mund mbasë të siguronim edhe shujtat të ngrohta përfëmijët prej klasës 1 deri 5 nga kuzhina popullore në këtë rast, prandaj këto propozime tonat shpresoj që ekzekutivi nuk i merr si kërkesa abstrakte të opozitës, mirëpo i merr si një tendencë.

**Nol Nushi** tha se plani i biznesit i kësaj ndërmarrjeje është minimalist për ndërmarrjen dhe kjo më jep shpresë sepse duke qenë minimalist aty mundesh me shtua shumë gjëra dhe mundesh me rrit përfomancën e kësaj ndërmarrje. Ka shumë mundësi qysh kjo ndërmarrje mundet me u rrit edhe me u zhvillua po kjo nuk mundet me u bërë sot, sot mundet vetëm me u themelua. Pres që të gjithë bashkërisht kemi me votua dhe me ia shtua Prishtinës edhe një element shtesë e cila ka me mbet këtu pavarësisht kush do të jetë në pushtet.

**Hafiz Krasniqi** tha se ideja për themelimin e ndërmarrjeve publike komunale besoj që është një ide e cila është e qëlluar dhe ide e cila do të jetë në shërbim edhe e qytetareve edhe Prishtinës edhe Kuvendit Komunal. Ndërsa unë i përkrahi vendimet e shumë kolegeve këtu që u diskutuan rrith konceptit edhe formës si do të jetë plani i biznesit edhe si do të jetë koncepti i formës të ushqimit edhe çka do të përfshihet në këtë. Ne do ta kontrollojmë këtë ndërmarrje edhe përmes aksionareve edhe bordit të drejtorëve, kështu që obligohemi pastaj që rregulloret të cilat e përcaktojnë e rregullojnë veprimtarinë e kësaj ndërmarrje janë pjesë përbërëse e cila e përcakton volumin e punës edhe ligjshmërinë e punës së kësaj ndërmarrje.

**Kryesuesi konstatoi se me 35 vota për 2 kundër dhe 4 abstenime, u miratua vendimi për themelimin e ndërmarrjes publike lokale "Kuzhina Qendrore" SHA, në Prishtinë**

#### **Pika e katërt**

**Propozimvendimi për lënien në shqyrtim publik të Projektrregullores për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës se Prishtinës**

**Eman Rrahmani** tha se si rregullore e propozuar është e mangët dhe lënë hapësirë të shumtë për manipulimin e parkingjeve si ato private ashtu edhe publike. Andaj edhe kemi propozimet tona para se të dal në dëgjim publik e natyrisht që do ti kemi edhe kur të kthehet për miratim në Kuvend Komunal. Kërkojmë që të votohen këto propozime:

Neni 4, pika 3 të shtohet edhe një pikë, të shtohet pika 3.12, e cila do ta përcaktonte më kuartë parkingun; Pika 3.8 lë hapësirë për abuzim sepse të gjithë aplikojnë për leje të përkohshme duhet të definohet qartë në cilat raste dhe në cilat kushte jepen këto leje; Pika e 6-të, vend parkingjet në rrugë dhe trotuare, të hiqet fjala në trotuare; Pika e 7-të nuk përmendet askund plani i mobilitetit kjo vlen për rregulloret në përgjithësi lokacioni parko dhe udhëto do të duhej të përcaktoheshin sipas studimit të bërë nga plani i mobilitetit.

Neni 6-të pika 4, pse të përcaktohen rrugët me dokumente të planifikimit hapësinorë kjo blokon implementimin e kësaj rregullore; Neni 16-të pika 2, ti hiqet e drejta e miratimit të Kryetarit për çmimore, ekzekutivi duhet të jetë vetëm propozues kurse vendimi duhet ti takoj Kuvendit Komunal. Po ashtu neni 22 të permisohet sepse ky nen i referohet nenit 18. Përveç këtyre propozimeve ai bëri edhe pyetje shtesë: Kur do të përcaktohen hapësirat e parkingut dhe kush do ti përcaktoj ato.

**Drilon Pireva** shprehu shqetësim ndaj parafolësit i cili tha se z. Eman Rrahmani ka dal në të gjitha televisionet duke shpif, duke gënjer, duke i frikësuar njerëzit me aplikua me konkurruar e duke e deligjitimuar nëpër secilin konkurs. Rrjedhimisht ky ka dashtë duke shpifur me i futur vetëm personat e tij në bord, fatkeqësisht për të, e fatmirësisht për ndërmarrjen ata persona nuk i kanë plotësuar kriteret edhe kjo është vërtetuar edhe me Ambasadën Angleze. Tash është shpall konkursi prapë edhe i kisha ftuar te gjithë personat që mendojnë që minden me bërë punën në bord të drejtorëve me aplikuar mos me i dëgjuar këto shpifje.

**Agim Gashi** tha se fusha e parkingjeve në Prishtinë është fushë e lënë plotësisht pas dore, sepse atëherë kur e morëm vendimin për themelimin e kësaj ndërmarrje u dha njëfarë sinjali i shpresës se do të stabilizohet dhe do të menaxhohen parkingjet në Prishtinë. Qeveria Komunale inkason mjete në mënyrë të paligjshme nga parkingjet në Prishtinë dhe nuk është

Faqe 5 nga 13

mirë për një kryeqytet me krijuar me gjeneruar mjete në mënyrë të paligjshme, sepse 5 vite nuk është tenderuar dhënia e hapësirave në shfrytëzim. Ndoshta do të kalojë kjo do të diskutohet e do të sillet prapë këtu dhe do të votohet, por si do të implementohet pastaj. Kame një drojë që do të behet njëfarë kaosi në këtë aspekt dhe ma mirë ka qenë me vepruar në mënyrë tokësore me rregulluar infrastrukturën për aq sa ka hapësirë dhe me pa cilat janë kapacitetet për parkimin e veturave sipas një standardi që ne po pretendojmë me e instaluar në komunën e Prishtinës.

**Suzan Kika** tha se në parim e përkrahi këtë iniciative për mënyrën e të operuarit të parkingjeve ngase edhe mund të jetë një zbutje e problemit për parking edhe që njëkohësisht Komuna të mund të vjet të hyra. Mendoj se duhet të kemi kujdes me parkingjet private të mos ngarkohen shumë me kritere dhe me procedura.

Në pikën 7, vendparkimet, parko dhe udhëto, gjithsesi se ideja është e mirë por e pa realizueshme ngase kërkon sipërfaqe të madhe gjë që Komuna e Prishtinës nuk e ka kurse sektori privat nuk e besoj se do të merret me këtë aktivitet ngase pronat e periferisë së Prishtinës janë me më interes dhe rentabile në destinacione tjera.

**Hafiz Krasniqi** vërejtje bëri për nenin 17 pika 3 që ka të bëjë rreth kohës dhe propozoj që ajo të zgjatet. Të zgjatet ajo pjesë ku është nga ora 7 deri 21 dhe nga ora 7 deri në orën 15 duhet ta kemi një zgjatje të kohës për arsy se po me duket pak kohë e shkurtë e shfrytëzimit të këtyre parkingjeve. Te neni 19 edhe neni 20 që e përkufizon edhe nenin 21, kërkoi që në çdo pasus ku përmendet inspektorit të specifikohet, titullohet për lëmin, pra të thuhet inspektori komunal.

**Kryesuesi konstatoi se me 30 vota për dhe 1 abstenim, u miratua vendimi për lënie në shqyrtim publik të Projektrregullores për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës se Prishtinës.**

#### Pika e pestë

#### Propozim vendimi për emërtimin e rrugës me emrin "Bernard Kushner"

**Halim Halimi** kërkoi të dijë se kush e propozon këtë vendim për emërtimin e rrugës ku është në lagjen Arbëria me emrin "Bernard Kushner". Ne si grup parlamentarë e mirëpresim shumë emërtimin e një rrugë në kryeqytet me emrin "Bernard Kushner", mirëpo gjithmonë kërkojmë që procedurat të përfillen, pra do të thot që është dashtë të formohet një komision i cili do ti propozonte Kuvendit për emërtimin e rrugëve.

**Egzon Azemi** tha se edhe ne jemi që kur të formohet komisioni të merret me këto emërtime të rrugëve, sepse nuk mundemi vazhdimisht në seancat që vijnë me emëruar rrugë në këtë formë.

Ai më pas e parashtroi një kërkesë duke cekur që dita e dita e diele të jetë ditë pushimi për sektorin privat, pra punëtorët e sektorit privat që shtypen jashtëzakonisht shumë që punojnë me orar të tej zgjatur pa pagesë e qe kanë shumë e shumë padrejtësi tjera që ju shkaktohen për çdo ditë e meritojnë që një ditë në javë ta kenë pushim. Prandaj besoj që këtu jemi të gjithë për, që ta votojmë këtë rregullore pra ku punëtorëve të sektorit privat do t'i mundësohet e diela ditë pushimi.

**Vlbona Petrovci** propozoi që në njëren nga mbledhjet e radhës së Kuvendit të ketë parasysh emërtimin e ndonjë rrugë me emrin e Eva Brendllit- ish hebreje e lindur në Poloni, doktore e Shkencave Politike dhe doktore e të Drejtave të Njeriut e diplomuar në Havard dhe profesorë në 6 Universitetet Amerikane dhe ishte anëtare e Lidhjes Qytetare Shqiptare Amerikane dhe veprimtare shumë vjeçare e Lëvizjes Politike të Kosovës.

**Rifat Deri** tha se që nga marsi i vitit të kaluar kamë kërkuar që të formohet një komision i ri për emërtimin e rrugëve. Besoj që kjo punë do të mbyllët nëse ne marrim vendim të saktë, se cila ditë do të caktohet përtu takuar shefat e grupeve parlamentare për caktimin e rrugëtimit të caktimit të komisionit të ri dhe të shqyrtojmë këtë problem një herë e përgjithmonë dhe te mbyllim sa i përket kësaj çështje.

**Kryesuesi** tha se vërtetë se ka mbet me u taku shefat e grupeve dhe do të takohemi. Kanë genë disa rrethana po që sot po e caktojmë të martën ora 10 shefat e grupeve parlamentare dhe e shqyrtojmë këtë çështje për caktim të komisionit për emërtim të rrugëve të reja.

**Arbenita Murseli** tha se sa i përket këtij propozim vendimi për emërtimin e rrugës me emrin "Bernard Kushner" personalisht e mirëpres një vendim të tillë duke e ditur edhe kontributin që e dha mjeku francez Kushner në vitet e 90-ta, ku qindra fëmijë u helmuani në shkollat shqipe nga ana e serbëve. Andaj në shenjë mirënjojje për kontributin që dha ky personalitet absolutisht jam pro këtij vendimi.

**Suzan Kika** tha se pasi po respektojmë personalitetet për merita ndaj shtetësisë së Kosovës me mbështetjen e tyre si personalitetet nga shtete që vijnë atëherë propozoi që ndonjë nga rrugët të emërtohen edhe me emrin e Ana Lin- ish ministre e punëve të jashtme të Suedisë e cila ka dhënë kontribut të çmueshmë dhe permanent duke përkrahur të drejtat e popullit shqiptarë në Kosovë për çlirim dhe liri.

**Naime Osmani** kërkoj nga ky Kuvend ti respektoj fjalët dhe diskutimet e anëtarëve se ka mbet për këtë mbledhje me qenë i formuar komisioni, dhe neve prapë nuk na vjen as në rend ditës. Ka shumë emra shumë rrugë të pa emërtuara dhe këtu të gjitha propozimet duhet ti shkojnë normal komisionit për emërimin e rrugëve, andaj mbes me shpresë që në seancën tjetër do të jetë komisioni i formuar dhe të shkojmë me propozimet tona.

**Vlora Dumoshi** tha se do të ishte më mirë me menduar që këto personalitetet me i shpërblyer ndryshe jo vetëm me emra të rrugëve, jo vetëm diku, pra të jetë një vend më i ekspozuar, më adekuat si psh te rrethi rruga për Fushë Kosovë. Është përtë ardhur keq që shumë njerzë që kanë dhënë kontribut janë në do rrugica në disa pjese të cilat ma mire është mos me qenë. Për emërtimin e rrugëve kamë kërkuar që paraprakisht të jetë i formuar një komision prej historianëve të tjera.

**Vala Peshku** tha se me falënderimin më të madh përtë gjitha forcat ndërkombëtare që kanë kontribuua në lirinë tonë, unë mendoj si shoqëri duhem me kapërcyer një herë e përgjithmonë këtë ndjenjën e inferioritetit apo të përkuljes. Monumenteve nuk duhem me ju përkulur, mirëpo si shoqëri duhem një herë e përgjithmonë me e kuptuar.

**Kryesuesi konstatoi se me 27 vota për, 5 kundër dhe 2 abstenime, u miratua vendimi për emërtimin e rrugës me emrin "Bernard Kushner".**

## Pika e gjashtë

### Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e Monumentit të Lirisë

**Vlora Dumoshi** tha se ky propozimvendim është i mangët për arsyen se për monumentin e propozuar nuk na është sjellë asnjë fotografi e cila tregon përbajtjen e këtij monumenti. Për mua kjo kërkesë është shumë e mangët dhe kërkoi të dijë se a merr pjesë dikush prej Komunës së Prishtinës në Këshillin organizativ por edhe në përzgjedhjen e kësaj skulpture, se kjo po ndodh në hapësirën e kryeqytetit tonë.

**Osman Bllaca** tha se kërkesa ka ardhur prej presidencës ashtu qysh e kemi bashkangjitur ata kanë bërë marrëveshje edhe me Universitetin e Prishtinës kanë marr pëlqim prej Rektoratit, kështu që neve si Komunë na e kemi për obligim me shiquar në bazë të Planit rregullues urban se çka parashihet për atë zonë.

**Shefki Gashi**, kërkoi nga të gjithë anëtarët e Kuvendit që Monumenti i Lirisë të vendoset në qendër të Prishtinës.

**Egzon Azemi** tha se jam për vendosjen e këtij monumenti por jo në qendër të qytetit absolutisht, kemi mjaftueshëm simbole të tillë. Nuk ka vend më të mirë se për këtë obelisk i cili simbolizon lirinë se sa të jetë në Varrezat e dëshmorëve, aty te varrezat e dëshmorëve janë edhe dëshmorët që kanë dhënë jetën për liri, aty ti falënderojnë edhe të gjithë ata që kanë kontribuar për lirinë tonë.

**Agim Gashi** tha se pajtohem që kjo përmendore të jetë në një vend frekuentues dhe simbolika e tij të reflektoj me komunikuesin, sepse nuk mund të izolohet një përmendore që ka një simbolik për çlirim e vendit. Një hapësirë e izoluar nuk komunikon me qëllimin e vendosjes së atij monumenti.

**Leutrim Retkoceri** ishte i mendimit se ky monument i lirisë ishte dashur me qenë më në qendër, me qenë një vend më afér rrugës së frekuentimit.

Në këto kushte unë mendoj se duhet të na funksionoj logjika më mirë të gabojmë pak por të bëjmë diçka, se sa duke menduar me qenë idealistë e mos me bërë asgjë.

Nëse nuk gjindet vend tjetër, ne e përkrahim edhe mendoj që duhet të bëhet, por nëse gjendet hiq nuk është vonë me ndërruar gur themelin e me qitura në ndonjë vend edhe më të mirë.

**Vala Peshku** tha se pajtohem me propozimet që ndoshta diku në qendër të qytetit ka qenë më mirë me u vendos ky obelisk, mirëpo duke e pasur parasysh gjatësinë e saj dhe hapësirën e cila iu kishte dashur unë nuk e shoh të mundshme edhe me u vendos në qendër të qytetit.

Në anën tjetër unë po e shoh prej një këndi shumë më të bukur edhe më të mirë vendosjen në oborrin e Universitetit, në një anë është Rektorati në një anë janë Fakultetet, është Biblioteka Kombëtare.

**Rifat Deri** tha se vendi më adekuat dhe që ka shumë hapësirë për ngritjen e këtij obelisku kishte me qenë ajo hapësira në mes Rrethit dhe Shkollës së Mesme të Mjekësisë.

**Visare Gorani - Gashi** ishte e mendimit që përmendorja e cila gjindet në mes të Qeverisë dhe Komunës pra ish përmendorja e Vllazni- bashkimit të emërohet Përmendorja e Lirisë edhe mos të mendojmë një vend tjetër ku ta kemi.

**Eman Rahmani** tha se vendi i duhur për vendosjen e këti monumenti është tek varrezat e dëshmorëve, dhe mendoj se nuk duhet ta votojmë një propozim të tillë por ti kërkohet ekzekutivit që ta ndërroj lokacionin dhe të vendoset aty.

**Nol Nushi** tha se ne mundemi sot me marr vendim që Prishtina me pas një Monument të Lirisë që i kushtohet ndërhyrjes së NATO-s, gur themelin ia përcaktojmë në ndërkohë.

Pra nuk kemi nevojë me u ngutur me qit themele se në fund nëse ato themele ne praktikisht jemi duke dhënë pronë, as nuk kemi me përcaktuar dizajn, as asgjë hiq, vetëm lokacionin. Ky nuk është vendim i Komunës së Prishtinës, është një kërkesë nga presidenca, një propozim për një lokacion.

Naime **Osmani** propozoi që ai Monument apo Obelisk të vendoset te varrezat e dëshmorëve edhe pse është në iniciativën e presidencës, atëherë edhe presidenti i parë ka qenë Dr. Ibrahim Rugova. Është varri i presidentit aty, janë varrezat e dëshmorëve aty dhe vet Monumenti i Lirisë do ti përfshinë të gjithat.

**Halim Halimi** tha se është tejet shqetësuese pse edhe Rektorati ka dhënë pëlqimin që ky monument i lirisë të vendoset në at hapësirë, jo që është Rektorati kundër një monumenti të tillë, por për shkak të hapësirës e cila nuk është e përshtatshme në at vend për një monument të tillë. Kisha propozua që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen tjetër edhe një herë Drejtoria e Planifikimit Strategjik edhe në konsultim me ekspert të fushave të ndryshme dhe të na vjen me një propozim tjetër për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit.

**Kryesuesi konstatoi se me 18 vota për, 19 kundër dhe 3 abstenime nuk u miratua Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e Monumentit të Lirisë**

#### **Pika e shtatë**

#### **Pyetje dhe përgjigje**

#### **Mirsad Vitia, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave**

1. A mund të investohet në kanalizim tek rruga "Nekibe Kelmendi", kanalizim ky i cili është në ambient të hapur dhe kundërmon erë të pa këndshme?

2. Çka është puna me punëtorët e Pallatit të Rinisë, ku ka katër muaj që skanë marrë rroga dhe aksionarët e emëruar nga Kuvendi Komunal Prishtinë dhe anëtarët e boritit të Ndërmarrje Publike Pallati i Rinis nuk janë duke u merr me punëtorët e Pallatit por si t'iu ndihmojnë përmbaruesve. Çka është duke ndodh me mjete të dhëna nga Kuvendi Komunal i Prishtinës për këtë Ndërmarrje.

**Gëzim Mehmeti**, drejtor i Drejtorisë së Investimeve kapitale dhe menaxhimit të Kontratave tha se rruga "Nekibe Kelmendi" është në projekt dhe punët për rregullimin e kanalizimit do të fillojnë së bashku me rregullimin e kanalizimit edhe të disa prokave në zonën e Hajvalisë.

**Shefqet Osmani**, në cilësin e anëtarit të Komisionit të akcionarëve në ndërmarrjen “Pallati i Rinisë” tha se në i kemi kryer të gjitha obligimet ndaj punëtorëve të kësaj ndërmarrje kështu që janë të paguara të gjitha pagat.

### Suzan Kika për drejtoren e Drejtorisë së Shërbimeve Publike

A është në projekt instalimi i ngrohjes qendrore nga Termokosi për banesat e bardha në lagjen “Kodra e Diellit” dhe kur do të filloj dhe pse nuk ka ndodhë deri më tani.

**Medina Braha**, drejtore e drejtorisë së Shërbimeve Publike tha se janë duke u bërë disa zgjerime të shtrirjes së rrjetit për ngrohje qendrore, por paraprakisht duhet të parashtrohet kërkesa nga banorët e asaj zone.

**Gëzim Mehmeti**, drejtor tha se sa i përket zgjerimit të rrjetit të ngrohjes qendrore kompetent është NL Termokosi, ku lejet për investime jepen nga Drejtoria e Investimeve Kapitale. Në këto zgjerime është paraparë edhe zona e lagjes Kodra e Diellit.

**Eman Rrahmani** për drejtorin e Drejtorisë së Inspepcionit, për drejtoren e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave

1. Tregu i shpezëve në Kodrën e Trimave vepron të martave dhe vepron jashtëligjshëm dhe kur përfundohet puna aty mbesin mbetjet dhe banorët aty janë në rrezik prej epidemive të ndryshme
2. Një pjesë e banorëve në lagjen Kodra e Trimave, mbrapa Princit të Arbitr nuk kanë ujë, thuajse fare ujë të pijhëm edhe pse për këtë është blerë një pompë e cila asnjëherë nuk ka funksionuar. Ku ka mbet procesi dhe pse nuk po përfundohet.
3. Po ashtu edhe një pjesë të banorëve në Bardhosh mbrapa shkollës “Anton Zako Çajupi” janë disa familje që nuk kanë kycje fare në ujësjellës.
4. Në rrugën “Vllezërit Fazliu”, tash “Fahri Fazliu” janë duke u punuar trotuaret dhe kërkoi që të bëhet një koordinim mes Komunës, KEDS-it dhe kompanisë së Ujësjellësit që ti harmonizojnë punët në rast instalimi të kabllove apo gypave të ujësjellësit.
5. Ruga Drenica është në një gjendje shumë të keqe dhe kërkoi që të bëhet sanimi i gropave.
6. Po ashtu kërkoi që të rregullohen më mirë pusetat në rrugën për në Kolovicë , pasi që ato janë dëmtuar në masë të madhe.

**Gëzim Mehmeti** drejtor tha se rruga “Vllezërit Fazliu” përfundon përpunim me standardet për arsy se e kemi vetëm një pjesë te vogël për trotuare dhe aty janë të vendosura të gjitha kabllot. Ndërsa sa i përket sanimit të gropva tha se sivjet kemi paraparë sanimin e tyre, intervenime në rikonstruim të rrugëve dhe shtrimi me asfalt. **Adonis Tahiri**, drejtor i Drejtorisë së Inspepcionit tha se sa i përket tregut të shpezëve atje është një problem i ka hershem pra dhe ka mbet që të ndërtohet një thertore ku do të mundemi ti orientojmë ne ata që veprojnë aty dhe pasi që të bëhet thertorja atëherë kemi me mundur me pas një zgjidhje përfundimtare këtë problem për shkak se jo vetëm Kodra e Trimave tashmë ka edhe nëpër zona tjera raste të ngjashme.

**Shefqet Osmani, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimin e Kontratave dhe për drejtorin e Drejtorisë së Inspepcionit**

1. Banorët e lagjes Hajdaraj në fshatin Koliq kërkojnë rregullimin e rrugës në gjatësi prej 2 km dhe tenderi që është shpallë për atë rrugë është shpallë vetëm për 800 m. Atje është komplet lagjja jetojnë aty.
2. Te shkolla fillore "Zenel Hajdini" janë hapur gropë rrith 15 cm dhe është kërkesë e banorëve që të bëhet sanimi i tyre.
3. Në në zonën industriale ku është edhe Tregu i Automjeteve, aty ai treg është shndërruar në gjithçka. Të dieleve aty rruga bllokohet prej shitësve të ndryshëm duke pamundësuar qarkullimin e lirë dhe kundërmon edhe erë e rëndë prej mbetejve të therjeve të pulave.

**Gëzim Mehmeti**, drejtor tha se në mungesë të mjeteve është paraparë që në fazën e parë të ndërtohen vetëm 800 m rrugë dhe pjesa tjeter e rrugës mbetet të vazhdoi në vitin e ardhshëm. Sa i përket sanitit të gropave, për atë rrugë është paraparë investimi komplet me asfalt që mos të bëhen investime të dyfishta.

**Adonis Tahiri**, drejtor tha se sa i përket dukurisë së shitësve të gjërave të ndryshme, probleme të tilla po shfaqen prej qendrës dhe kah periferia dhe në mungesë të inspektorëve kjo dukuri ende po vazhdon.

**Kushtrim Sopa, për drejtoren e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për drejtoren e Drejtorisë së Parqeve dhe për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave**

1. A do të merren masa urgjente për shqetësimin e qytetareve të Prronit të Njelpt, pasi që fabrika e cila bënë riciklimin e letrës mbetjet i ka hedhur në prrockë e cila përbante ujë natyral, ndërsa tani hedhja e këtyre materiale po shkakton dëme të mëdha ekologjike në atë pjesë?
2. A do të përmisohet dhe të trajtohet me më përgjegjësi mirëmbajtja e Parkut të Qytetit, të merren masa shtesë të sigurisë në Park, mbase është hapësirë kjo në zemër të qytetit dhe është i frekuentuar shumë, ku dukuritë negative shoqërore janë evidente a do të përmisohet infrastruktura e Parkut përreth tij rrugët trotuaret dhe parkingjet?
3. A do të rinovohet parku Arbëria me infrastrukturë ekzistuese dhe atë përcjellëse?
4. A do të merren masa për përmasimin e infrastrukturës sportive në qytetin e Prishtinës, si dhe hapësirave rekreative?
5. Qe veç është Drejtori këtu e dha edhe ma herët përgjigjen por e kam detyrë me e lexuar. Pse nuk po përmisohet apo sanohet gjendja e rrugëve në qytet edhe pse është proklamuar se me ngritjen e temperaturave do te merren masa në këtë drejtim?

Faleminderit

**Gëzim Mehmeti** tha se në Përroin e Njelpt është paraparë intervenimi, vendosja e kanalizimit po ashtu komplet rikonstruimi i rrugëve.

### **Sami Salihu, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave dhe për drejtoren e Drejtorisë së Shërbimeve Publike**

- Banorët e lagjes Mati 1, konkretisht ata afër rrugës "Jakov Xoxa" kanë kërkuar që të ndërtohet kjo rrugë, ose të futet në listën e rrugëve të cilat do të ndërtohen nëse nuk është në listë atëherë të bëhet pas rishikimit të buxhetit.
- Banorët afër rrugës "Bajram Bahtiri" kërkojnë që të funksionalizohet ndriçimi i kësaj rruge e cila ka mbetur në terr që një muaj.

**Gëzim Mehmeti**, drejtor tha se në rrugën "Jakov Xoxa" ndërtime ende nuk kanë përfunduar, pasi që gjatë realizimit të projektit kemi hasur në probleme pronësore. **Medina Braha**, drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike tha se se KEK-u kur po i dislokon shtyllat elektrike atëherë automatikisht po mbesin edhe pa ndriçim disa pjesë të qytetit.

### **Naime Osmani për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, për drejtoren e Drejtorisë së Shërbimeve Publike**

- Edhe përkundër kërkeseve që i ka bërë në mënyrë zyrtare kryetari i BL të fshatit Besi, as një projekt në infrastrukturën rrugore nuk është realizuar
- Po ashtu në këtë fshat banorët janë shumë të rrezikuar prej qenve endacak sidomos fëmijët.
- Po ashtu kërkoi që të shtrohet me asfalt rruga Besi- Rimanishtë, rrugë e cila ka gropë të mëdha dhe duhet me u zgjerua.
- Banorët afër rrugës "Xhemail Osmani" në Besi kërkojnë ndriçimin e kësaj rruge.
- Çka po ndodh me autobusët e Trafikut Urban të cilë qarkullojnë vetëm deri në Bardhosh dhe nuk vazhdojnë më tutje si deri në Teneshdoll, Prugovc, Barilevë, Rimanishtë, ku është arsyja.
- Pse Komuna e Prishtinës e parasheh që në rast pakënaqësie të kandidatit të cilit nuk ju ka ndarë bursa të paraqes ankesë, e në fakt ankesa nuk përfillet fare.
- Në shkollën Nexhmi Mustafa në Prugovc qe një vit janë ndërruar dyer dhe dritare dhe dritaret paraqesin rrezik nga se ato nuk janë të fiksuar ashtu si duhet dhe paraqesin rrezik për nxënësit e shkollës.

**Medina Braha**, drejtoreshë tha se për qentë endacak është një kontratë që është lidhë me OJQ, ata i marrin qentë i sterilizojnë, i vaksinojnë kundër tèrbimit dhe helmimit Ndriçimin në Besi do ta shqyrtojmë dhe vazhdimisht kemi kërkesa për zgjerim të ndriçimit të rrugëve. Sa i përket Trafikut Urban, kamë formuar një ekip të cilët janë duke e bërë planin e linjave sepse duhet të del prej Planit të Mobilitetit. Ka shumë pjesë të Prishtinës që nuk janë të përfshira me transport, tash ky plan i linjave ka me përfshirë edhe Trafikun Urban edhe atë privat.

**Gëzim Mehmeti**, drejtor tha se nëse për pjesën rurale kemi caktuar nga një prioritet nga çdo Bashkësi Lokale, ka të bëjë edhe me Besinë sivjet. Ndërsa sa i përket zgjerimit të rrugës Besi- Rimanisjht aty ka shumë ndërtime pa leje dhe është vështirë me u realizuar ai projekt për zgjerim të rrugës.

**Arbër Vokrri për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave për drejtorin e Drejtorisë së Inspepcionit dhe për drejtoren e Drejtorisë së Shërbimeve Publike**

- A ka ndonjë pritshmëri ose a ka ndonjë afat kur pritet me u zhbllokua situata për të filluar punët në platon e kurrit dhe a mundet ndërkohë deri sa të vij ai moment me u ndërhy diçka. Aty ka probleme p.sh. me ato tubacionet dhe kanalizimet sa bien shi ose ndonjë reshje bëhet aty vërshim nuk ka ndriçim dhe hapësirat që kanë qenë të parapara me qenë të gjelbëruara kanë mbet të pa përkujdesur nuk duken mirë.
- Po ashtu në atë pjesë të kurrit hapësirat publike për lëvizjen e këmbësorëve janë ngushtuar shumë nga zgjerimi i bizneseve kryesisht kafiterive dhe banorët kërkojnë që të merren masa për lirimin e hapësirave
- Gjithashtu në at pjesë është edhe një restorant që me ushtrimin e veprimtarisë së tij i pengon aty banorët nga zhurma dhe vibracionet e makinave deri në orët e vona të natës për prodhimin e produkteve që i shpërndan në gjithë Kosovën.

**Gezim Mehmeti**, drejtor tha se ndërtimi i platos ka filluar në 2015 dhe punimet që janë kryer mirë do të kompensohen ato që nuk janë kryer mirë do të kërkohet nga kompania që të bëjë sanimin sipas projektit.

**Medina Braha**, drejtore tha se për lëshimin e lejeve për zgjerimin e terasave bazohemi ne një rregullore që është për shfrytëzimin e hapësirave publike. Personalisht mendoj që ajo rregullore ka nevojë për konkretizime më të mëdha sepse është e caktuar p.sh. deri në 1.70 cm, por nuk e konkretizon sakt se sa sipërfaqe lejon. Në këtë rregullore ka nevojë për përmirësimë, ka nevojë edhe për me i caktua zonat.

**Adonis Tahiri**, drejtor tha se ne si inspekcion shkojmë i shohim ato biznese dhe nëse një lloj i tillë i biznesit ka nevojë për pëlgim sanitari atë pëlgim ja japim përndryshe nuk mundemi me ndikua në veprimtarinë që e bënë ai.

Mbledhja përfundoi në orën 16:00

**Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvendit  
Agim Kuleta**

